



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË**

**SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE
DHE PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE
(Specialist Finance për Zbatimin e Buxhetit dhe Projekteve në Këshillin e Qarkut Vlorë)**

Lloji i diplomës “Shkenca ekonomike”, niveli minimal i diplomës “Master Profesional”

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe të Kreut II, IV dhe VII të VKM Nr. 243, datë 18.03.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar, Këshilli i Qarkut Vlorë shpall procedurën e lëvizjes paralele dhe pranimin në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive për pozicionin :

Specialist Finance për Zbatimin e Buxhetit dhe Projekteve, Sektori i Financës/Buxhetit dhe Shërbimeve në Këshillin e Qarkut Vlorë, kategoria III B

Pozicioni më sipër u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele në shërbimin civil!

Vetëm në rast se, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se pozicioni është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimin në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Për të dy procedurat lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumentave për LËVIZJE PARALELE:	14 Shtator 2022
Afati për dorëzimin e dokumentave për PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL:	19 Shtator 2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI I QARKUT VLORE

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin më sipër është:

- Menaxhon fondet buxhetore të miratuara duke siguruar përdorimin me efektivitet dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për fondet publike;
- Përgatit raportime mbi përdorimin e fondeve të buxhetit për shpenzimet (pagat, sigurimet shoqërore e shëndetësore, shpenzimet operative dhe investimet);
- Ndjek detyrat, që rrjedhin nga Ligji Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” si dhe aktet e tjera në zbatim të tyre.
- Mban llogaritë financiare në përputhje me aktet ligjore në fuqi për kontabilitetin;
- Harton urdhër pagesat e shpenzimet për Degën e Thesarit dhe për bankat.
- Përgatit evidencat statistikore financiare.
- Evidenton shpenzimet mujore dhe vjetore sipas zërave të buxhetit nëpërmjet ditarëve përkatës.
- Harton buxhetin e projekteve me financim të huaj ku institucioni aplikon.
- Menaxhon fondet e projekteve me financim të huaj ku institucioni është fitues.

LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet minimale që duhet të plotësojë kandidati për këtë procedurë janë:

- a) Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori (ekzekutive) për të cilën aplikon III - B ;
- b) Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c) Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a - Të zotërojnë diplomë të nivelit minimal "Master Profesional" në "Shkenca ekonomike". *(Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë; Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*
- b - Të kenë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në profesion në administratën shtetërore dhe/ose institucione të pavarura.
- c-Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.
- d-Të zotëroj mirë gjuhën angleze. Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI I QARKUT VLORË

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a - Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
- b – Kopje të diplomës (përfshirë diplomën Bachelor) e noterizuar. *(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*
- c – Kopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë) e noterizuar;
- d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g - Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h - Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, Zyra e Burimeve Njerëzore brenda datës **14.09.2022, në adresë: Këshilli Qarkut Vlorë, Zyra e Burimeve Njerëzore, Pallati i Kulturës “Labëria”, Kati i III –të , Vlorë**

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **15.09.2022**, Këshilli i Qarkut Vlorë do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen e internetit të Këshillit të Qarkut Vlorë, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Këshilli i Qarkut Vlorë, nëpërmjet adresës së e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar.
- Ligjin Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.
- Ligjin Nr. 9131 datë. 08.09.2003 “Për rregullat e Etikës në Administratën Publike”.
- Ligjin Nr. 9367 dt. 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.
- Ligjin Nr. 10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.
- Ligjin Nr. 115/2021 “Për Buxhetin e vitit 2022”.
- Ligjin Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.
- Ligjin Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI I QARKUT VLORË

- Ligjin Nr. 10383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligjin Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligjin Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligjin Nr. 10399, datë 17.03.2011 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”.
- Ligjin Nr. 9840, datë 10.12.2007 “Për ratifikimin e “marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane për rregullat e bashkëpunimit për asistencën për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA)”, i ndryshuar.
- Njohuri mbi Practical Guide/PRAG për procedurat e prokurimit për veprimet e jashtme të BE - së.
- Aktet nënligjore të dala në zbatim të ligjeve të mësipërme.

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen për jetëshkrimin, eksperiencat, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe vlerësimet pozitive.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Struktura e ndarjes së pikëve të vlerësimit të kandidatëve është, si më poshtë vijon:

- a) 40 pikë për dokumentacionin e dorëzuar, i ndarë: 20 pikë për përvojën, 10 pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse, si dhe 10 pikë për certifikimin pozitiv;
- b) 60 pikë intervista me gojë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultetit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al”

<http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Këshilli i Qarkut Vlorë do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të Këshillit të Qarkut Vlorë.

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për shpalljen e fituesit.

2 PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI I QARKUT VLORË

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende është vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Këtë informacion do ta merrni në faqen e Këshillit të Qarkut Vlorë.

2.1

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NE SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë shërbimit civil të cilët plotësojnë kërkesat e nenit 21 të Ligjit Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.:

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:

- a - Të jetë shtetas shqiptar;
- b - Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c - Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d - Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e - Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f - Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e veçanta si vijon:

- a - Të zotërojnë diplomë të nivelit minimal "Master Profesional" në "Shkenca ekonomike". (Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë; Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).
- b - Të kenë të paktën 6 (gjashtë) muaj përvojë pune në profesion, në administratën shtetërore dhe/ose institucione të pavarura.
- c-Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.
- d-Të zotëroj mirë gjuhën angleze. Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së.

2.2

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

a - Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>

b – Kopje të diplomës (përfshirë diplomën Bachelor) e noterizuar. (Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI I QARKUT VLORË

e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).

- c – Kopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë) e noterizuar;
- d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g - Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h - Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, Zyra e Burimeve Njerëzore brenda datës 19.09.2022, në adresë: Këshilli Qarkut Vlorë, Zyra e Burimeve Njerëzore, Pallati i Kulturës “Labëria”, Kati i III –të, Vlorë.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **26.09.2022**, Njësi e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Këshilli i Qarkut Vlorë do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në shërbimin civil dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Këshilli Qarkut Vlorë, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar.
- Ligjin Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.
- Ligjin Nr. 9131 datë. 08.09.2003 “Për rregullat e Etikës në Administratën Publike”.
- Ligjin Nr. 9367 dt. 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.
- Ligjin Nr. 10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.
- Ligjin Nr. 115/2021 “Për Buxhetin e vitit 2022”.
- Ligjin Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.
- Ligjin Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.
- Ligjin Nr. 10383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligjin Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligjin Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligjin Nr. 10399, datë 17.03.2011 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI I QARKUT VLORË

- Ligjin Nr. 9840, datë 10.12.2007 “Për ratifikimin e “marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane për rregullat e bashkëpunimit për asistencën për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA)”, i ndryshuar.
- Njohuri mbi Practical Guide/PRAG për procedurat e prokurimit për veprimet e jashtme të BE - së.
- Aktet nënligjore të dala në zbatim të ligjeve të mësipërme.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a. Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- b. Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c. Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- deri në **15 pikë** për dokumentacionin e dorëzuar.
- b- deri në **60 pikë** për vlerësimin me shkrim.
- c- deri në **25 pikë** për Intervistën e strukturuar me gojë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al”

<http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

2.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Këshilli Qarkut Vlorë do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e konkurimit, do të marrin informacion në faqen e Këshillit të Qarkut Vlorë për fazat e mëtejshme të procedurës së konkurimit:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;
- mënyrën e vlerësimit të kandidatëve.

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Këshillit të Qarkut Vlorë duke filluar nga data **26.09.2022**.